



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik
-KUVENDI I KOMUNËS-

01. Nr. 353-5135/14
Kaçanik, 28.02.2014

Në bazë të nenit 12 dhe 14 lidhur me nenin 17 (b) dhe (r) të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, të nenit 34.5 Statutit të Komunës, të Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës 01Nr.353-5135/14 prej datës 21.02.2014, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë 28.02.2014, mori këtë:

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E PALESTRËS
SPORTIVE NË KAÇANIK

I.

Me këtë Vendim caktohet Lokacioni për ndërtimin e Palestrës Sportive në Kaçanik.

II.

Lokacioni i caktuar për ndërtimin e palestrës sportive gjendet në parcelën kadastrale nr. **00228-0** dhe në parcelën kadastrale nr. **00229-0**, me sipërfaqen e përgjithshme prej **01,44,96 ha**, në emër të Pasurisë Shoqërore Shoqëria Sportive "Lepenci" Kaçanik, Zona Kadastrale Bob.

III.

Me marrjen e këtij Vendimi, Shfuqizohet Vendimi i Kuvendit të Komunës Kaçanik, për caktimin e Lokacionit për ndërtimin e Palestrës Sportive në Kaçanik 01Nr. 16-4405/2013 i datës 11.02.2013.

IV.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit.

V.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës.

VI.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës, dhe Arkiva.

Arsyetim

Kryetari i komunës Kaçanik, na u është drejtuar me Propozim Vendim prej datës 21.02.2014, për caktimin e Lokacionit si në pikën II të këtij Vendimi për ndërtimin e Palestrës Sportive, me arsyetim se Lokacioni i përcaktuar me Vendim të Kuvendit të Komunës ; 01Nr. 16-4405/2013 i datës 11.02.2013 në Dushkajë, nuk i plotëson kushtet dhe paraqet rrezik përmanent nga lumi Lepenc dhe nuk ka infrastrukturës të mjaftueshme.

Ekzekutivi i komunës- DUKMM ka vlerësuar se Lokacioni i përcaktuar si në pikën II të këtij Vendimi ka një infrastrukturë të rregulluar dhe i plotëson të gjitha kushtet dhe kriteret e parashikuara urbanistike për ndërtim.

Duke u nisur në arsyetimet e ekzekutivit të komunës të potencuara si me lartë, se ndërtimi i një objekti të tillë është në interes publik të qytetarëve të komunës dhe ka arsyeshmërinë ekonomike, infrastrukturën si dhe afërsinë me qytetin. Kuvendi i Komunës Kaçanik, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryesuesi i Kuvendit
Xhelal Gashi